



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

28 Maj, 2009, Prishtinë

Z. Kjartan Björnsonn
Drejtues i Operacioneve
Zyra Ndërlidhëse e Komisionit të Bashkimit Evropian për Kosovë

I nderuari Z. Kjartan Björnsonn,

Ju faleminderit për përgjigjen në letrën e juaj të 11 Marsit 2009–D (09)KB/axh386–mbi procedurën e propozuar nga Administrata tatimore e Kosovës për trajtimin tatimor të kontratave të KE-së të cilat janë të pranueshme sipas programit IPA .

Nga përmbajtja e letrës së juaj ne mundë të konkludojmë se Zyra Ndërlidhëse e KE dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) janë në marrëveshje se si do të implementohet në praktikë neni 26 i marrëveshjes IPA .

Gjatë takimit tonë me përfaqësuesit e zyrës së juaj në fillim të prillit të këtij viti, ATK ka shpjeguar se në princip çështja e TVSH-së është çështje e Administratës Tatimore dhe se implementimi i neni 26 nuk lidhet vetëm me TVSH mirëpo edhe me tatimin në fitim/në të ardhura dhe tatimet tjera sikurse është shpjeguar në përshkrimin e bashkangjitur të implementimit . Veç kësaj, praktika ndërkombëtare gjithashtu është që misionet diplomatike dhe konsullore ti përmbushin obligimet e tatimit në burim lidhur me pagat dhe kontributet pensionale të të punësuarve vendore në mënyrë që këta të punësuar ti shmangen problemeve serioze financiare nëse do të duhet të paguajnë tatimin pas dorëzimit të deklaratës vjetore mbi Tatimin mbi të Ardhurat personale për të cilat nuk është bërë ndalja e tatimit në burim në rroga gjatë vitit tatimor. E njëjta gjë vlen edhe për kontributet pensionale.

Rregullat finale të punuara–shih bashkangjitur e “Përshkrimit të implementimit të neni 26 të marrëveshjes IPA” marrin parasysh të gjitha aspektet e neni 26 të marrëveshjes IPA mirëpo gjithashtu qëllimin që ECLO dëshiron të menagjoj kontraktorët e KE-së në mënyrë direkte lidhur me autorizimin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve me kërkesë për lirim nga TVSH-ja. Forma e aplikacionit që do të shfrytëzohet nga kontraktorët e KE-së për të kërkuar këtë autorizim të blerjes nga ECLO nuk është shqyrtuar në këtë përshkrim meqë kjo është saktësisht çështje e brendshme ndërmjet kontraktorit të KE-së dhe ECLO.

Nga ana tjetër Administrata Tatimore duhet të menagjojë nivelet e ndryshme të TVSH-së, çka do të thotë se duhet gjithashtu të ketë mundësinë e verifikimit të implementimit të saktë të TVSH-së në nivelin e kontraktorit të KE-së. Prandaj kopjet e nevojshme të dokumenteve sikurse është përshkruar në përshkrimin duhet të dorëzohen në ATK në mënyrë që të realizojnë këtë synim konkret.

Më pas, ATK me siguri mundë të pajtohet për të përpiluar një MIM me ECLO në mënyrë që të ofrojë baza ligjore për ECLO që të lëshojë urdhër blerjet me lirimet e TVSH-së.

ATK-ja gjithashtu ka ofruar sqarimet e nevojshme me shkrim për përfaqësuesit e juaj në pyetjen e paraqitur në letrën e juaj të 11 marsit 2009-D (09) KB AXH 396 gjatë takimit në prill.

Ne mezi presim që të takohemi me ju ose stafin e juaj për të bërë aranzhimet finale.

I juaji sinqerisht,

Naim Fetahu
Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës

Bashkangjitje: Përshkrimi i implementimit të nenit 26 të Marrëveshjes IPA



PËRSHKRIMI I IMPLEMENTIMIT TË NENIT 26 TË MARRËVESHJES IPA

I. Baza Ligjore:

Nën-paragrafi 1.3 i nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-114 të 18 dhjetorit 2008 Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

1. Teksti është si në vijim:

“Në importe ose në furnizime të financuara nga të ardhurat prej donacioneve të bëra Ministrive ose për Ministrinë në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe të rindërtimit në Kosovë, nuk do të ngarkohet tatim mbi vlerën e shtuar”.

2. Kuptimi i nën-paragrafit 1.3 të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-114:

Kuptimi që i është dhënë tekstit të këtij nën-paragrafi është saktësisht i njëjtë sikurse kuptimi i dhënë në tekstin e mëvonshëm të nenit 11,1 (c) të Rregullores së TVSH-së Nr. 2001/11 Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, e plotësuar me Rregulloret e ndryshme.

3. Teksti në draftin e ri të Ligjit të TVSH-së që aktualisht është dorëzuar në Kuvend:

Teksti¹ i cili është propozuar në draftin e ri të Ligjit të TVSH-së e cila është dorëzuar në Kuvend në mënyrë që të futet në përdorim me 1 Janar 2010, bazohet në tekstin e Nenit 11,1 (c) të Rregullores Nr. 2001/11 të përmendur më lartë.

¹ Është theksuar se në këtë tekst, është përmendur formulimi “projektet tjera duke përfshirë projektet e integritit Evropian”. Termi “Projektet e Integritit Evropian” definohet si “çdo projekt që ekzekuton një kontratë të KE nga një kontraktor i KE-së sipas nenit 26 të Marrëveshjes IPA që e bën të mundur implementimin e projekteve për Instrumentin e Para Anëtarësimit (IPA)”.

² Termi “Projektet e Integritit Evropian” nënkupton çdo projekt që ekzekuton një kontratë të KE-së nga një kontraktor i KE sipas nenit 26 të marrëveshjes IPA që e bën të mundur implementimin e projekteve për Instrumentin e Para-Anëtarësimit (IPA).

Teksti analitik është si në vijim:

“Nuk do të ngarkohet tatimi mbi vlerën e shtuar në:

“Importe ose furnizime

- Të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes të buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara nga kontratat,
 - Për përfitim të ministrive, autoriteteve lokale dhe organeve të tjera të rregulluara me ligj,
 - Nga:
- 1) Organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare dhe agjencionet e tyre, qeveritë, agjencionet qeveritare, organizatat qeveritare ose jo qeveritare në mbështetje të programeve humanitare dhe të rindërtimit; dhe
 - 2) Projekteve të tjera duke përfshirë projektet e integritimit Evropian ² në Kosovë”.

II. Përshkrimi i procedurës së regjistrimit të kontraktorëve të KE-së:

1. Regjistrimi i kontraktorëve vendor të KE-së:

Kontraktorët vendor të KE-së të cilët nuk janë të regjistruar për qëllime biznesi në Kosovë, i nënshtrohen rregullave që ekzistojnë për regjistrimin e biznesit të shoqëruar me regjistrimin e tatimpaguesve duke përfshirë regjistrimin për qëllime të TVSH-së.

Kontraktori vendor i KE-së i cili veç është i regjistruar për qëllime tatimore duhet të dorëzoj një kopje të certifikatës së statusit të kontraktorit të KE-së brenda 5 ditëve pas fillimit të aktiviteteve si kontraktor të KE-së.

Kontraktori vendor i KE-së i cili ende nuk është i regjistruar për qëllime tatimore duhet të dorëzoj një kopje të certifikatës së statusit të kontraktorit të KE-së në momentin e regjistrimit për qëllime tatimore mirëpo para fillimit të aktiviteteve të tij si kontraktor i KE-së.

2. Regjistrimi i kontraktorëve të jashtëm të KE-së:

2.1 Kontraktorët e jashtëm të KE-së menjëherë i nënshtrohen regjistrimit të përkohshëm për qëllime tatimore duke përfshirë regjistrimin për qëllime të TVSH-së në Autoritetin Qendror Tatimor. Ky regjistrim duhet të përcjellët me regjistrimin e bizneseve në pajtueshmëri me rregullat aktuale duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës. Ky kontraktor duhet të dorëzoj një kopje të statusit të kontraktorit të KE-së në momentin e regjistrimit të përkohshëm ose nëse veç është i regjistruar për qëllime tatimore Brenda 5 ditëve pas fillimit të aktiviteteve si kontraktor i KE-së.

2.2.Regjistrimi i përkohshëm në ATK shërben sigurisht për qëllime të përmbushjes së obligimeve tatimore që këta kontraktor të jashtëm do ti kenë lidhur me të punësuarit vendor si: ndalja e tatimit në burim në rrogat e tyre dhe kontributet e nevojshme pensionale sikur që imponohen në nën-paragrafin (2) c) të nenit 26 të marrëveshjes IPA. Kjo nuk do të thotë se një kontraktor i jashtëm i KE-së do të tatóhet në të ardhurat e biznesit të tij të fituara në Kosovë, e as nuk do ti nënshtrohet tatuaries për TVSH.

2.3.Certifikata e statusit të kontraktorit të KE-së: Shih Aneks 1.

Certifikata krijohet nga ECLO në 3 kopje (origjinale):
Origjinali Nr. 1: Një për dosjen e kontratës së ECLO-s
Origjinali Nr. 2: Një për kontraktorin e KE-së
Origjinali Nr. 3: Një për Administratën Tatimore.

III. TVSH:

Pjesa 1: Procedura lidhur me furnizimet e mallrave dhe shërbimeve në Kosovë

1. Procedura e TVSH-së:

Aneksi 2(1) – skema: Përshkrimi i procedurës së TVSH-së lidhur me furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të bëra **nga** dhe **për** kontraktorët e KE-së brenda kontekstit të kontratës së KE-së sikurse është definuar në nenin 26 të marrëveshjes IPA ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

2. Blerjet e mallrave dhe shërbimeve nga kontraktori i KE në Kosovë (shih modelin e modifikuar të Aneksit 3 të ECLO):

2.1. Urdhër blerja me kërkesë për lirim nga TVSh-ja:

2.1.1. Kontraktori i KE-së aplikon në ECLO për marrjen e formës së “Urdhër blerjes me kërkesë për lirim nga TVSh-ja”: Kontraktori i KE-së aplikon në ECLO dhe merr nga ECLO formën e plotësuar të “Urdhër blerjes me kërkesë për Lirim nga TVSH-ja” shih Modelin e modifikuar **Aneksin 3** të BE-së. Koncepti i Urdhër blerjes veç është zhvilluar brenda kontekstit të “Procedurës për blerjet e përjashtuara të 20 nëntorit 2006” nga Administrata Tatimore.

2.1.2. Urdhër blerja me kërkesë për lirim nga TVSH-ja krijohet në 4 kopje (origjinalet):

Origjinali Nr. 1: Një për dosjen e kontratës së ECLO
Origjinali Nr. 2: Një për kontraktorin e KE-së
Origjinali Nr. 3: Një për nën-kontraktorin/furnizuesin e kontraktorit të KE-së
Origjinali Nr. 4: Një për Administratën Tatimore

Kontraktori i KE-së pranon origjinalet Nr. 2, 3 dhe 4 dhe duhet të ja ofrojë Origjinalin Nr. 3 furnizuesit-nën-kontraktorit dhe Origjinalin Nr. 4 Zyrës Qendrore të ATK-së (*Departamentit të Edukimit të Tatimpaguesve*).

2.2. Faturat

2.2.1. Faturat e lëshuara nga kontraktori i KE-së për ECLO:

Kontraktori i KE-së lëshon fatura lidhur me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve sipas një kontrate të KE-së për Zyrën Ndërlidhëse të Komitetit Evropian në Kosovë (ECLO) duke respektuar principet fundamentale të përmbajtjes së Ligjit të TVSH-së së Kosovës³ aty ku aplikohen (Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2004, i datës 1 shtator 2001 mbi Implementimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar – Neni 12).

Këto fatura lëshohen në emër dhe në adresë të ECLO.

Kontraktorët e KE-së nuk ngarkojnë TVSh në faturat e tyre duke u bazuar në nën-paragrafin 1.3 të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-114 të 18 Dhjetorit 2008 Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Kontraktorët e KE-së që nuk e paraqesin TVSH-në në këto fatura, janë të obliguar që të tregojnë arsyet e lirimit. Prandaj duhet të përmendet teksti si në vijim: “Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve duke përfshirë punët, janë të liruara sipas nën-paragrafëve 1.3 dhe 1.5 të nenit 11 të Ligjit të TVSH-së Nr. 03/L-114 të 18 Dhjetorit 2008: Nga kontraktorët e KE-së nuk ngarkohet TVSH + <titulli i kontratës> + <numri i kontratës> + <data e referencës së urdhër blerjes me kërkesë për lirim nga TVSh-ja>.

2.2.2. Faturat e lëshuara nga furnizuesit dhe nën-kontraktorët e një kontraktori të KE-së për atë Kontraktorë të KE-së.

Furnizuesit dhe nën-kontraktorët e kontraktorëve të KE-së gjithashtu nuk ngarkojnë me TVSH kontraktorët e KE duke u bazuar në “Procedurën për blerjet e përjashtuara nga TVSH-ja të 20 Nëntorit 2006”. Në këto fatura nuk ngarkohet TVSH dhe furnizuesit dhe nën-kontraktorët janë të obliguar që ta përmendin arsyen pse është me zero shkallë e cila në fakt është lirim me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme për kontraktorin e KE-së.

Prandaj formulimi në vijim duhet të përendet nga nën-kontraktorët në faturat e tyre të lëshuara për kontraktorin e KE-së: “Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve duke përfshirë punët, janë të liruara sipas nën-paragrafit 1.3 të nenit 11 të Ligjit të TVSH-së Nr. 03/L-114 të 18 Dhjetorit 2008 + Procedura për blerjet e përjashtuara të 20/11/2006 : Kontraktorëve të IPA-KE nuk ju ngarkohet TVSH + <titulli i kontratës> + <numri i kontratës> + < të dhënat e urdhër blerjes me kërkesë për lirim nga TVSH-ja>.

2.2.3. Është theksuar se furnizuesit dhe nën-kontraktorët e kontraktorëve të KE-së i nënshtrohen rregullave normale të TVSH-së: Blerjet të cilat i bëjnë duhet të ngarkohen me TVSH mirëpo furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të cilat i bëjnë për kontraktorët e KE-së ngarkohen me zero shkallë (Terminologjia e BE-së: furnizimet e liruara për kontraktorin e KE-së me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme) – pra ata mundë të marrin të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme në deklaratat e tyre të TVSH-së

³ Ligji aktual i TVSH-së i Kosovës bazohet në principet e Direktivës së gjashtë të BE-së.

dhe rimbursimet e tyre të TVSH-së bien nën rregullat normale të të TVSH-së të implementimit dhe kontrollit.

2.3. TVSH-ja në nivelin e kontraktorit të KE lidhur me kontratat e KE-së.

Bilanci (TVSH e llogaritur – TVSH e zbritur) lidhur me blerjet vendore të mallrave dhe shërbimeve pra **çdo herë do të jetë zero në nivelin e Kontraktorit të KE-së** – procedura e punuar, i plotëson automatikisht të gjitha kërkesat e nën-paragrafit (2)(b) të nenit 26 të marrëveshjes IPA (nuk do të bëhet dorëzimi i deklaratës së TVSH-së, dhe nuk do të bëhet kërkesa për TVSH).

2.4. TVSH në nivelin e furnizuesve dhe nën-kontraktorëve të Kontraktorëve të KE.

Furnizuesit dhe nën-kontraktorët i nënshtrohen rregullave normale të TVSH-së: blerjet të cilat i bëjnë janë të ngarkueshme me TVSH mirëpo furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të bëra për kontraktorët e KE ngarkohen me zero shkallë (terminologjia e BE-së: furnizimet e liruarat për Kontraktorin e KE me të drejtën e zbritjes së TVSH-së). Furnizuesit dhe nën-kontraktorët pra mundë të ushtrojnë të drejtën e tyre të zbritjes së TVSH-së në deklaratat e tyre të TVSH-së dhe rimbursimet e tyre të TVSH-së bien nën rregullat normale të TVSH-së.

Pjesa 2: Procedurat lidhur me importin e mallrave në Kosovë

1. Procedura e TVSH-së:

Aneksi 2 (2) – Skema: Përshkrimi i procedurave të TVSH-së lidhur me importimin e mallrave të bëra brenda kontekstit të kontratës së KE-së sikurse është definuar në nenin 26 të marrëveshjes IPA ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

Importet e mallrave nga kontraktorët e KE-së lidhur me kontratat e KE-së janë të liruara nga TVSH-ja duke u bazuar në nën-paragrafin 1.3 të nenit 11 të Ligjit të TVSH-së Nr. 03/L-114 të 18 Dhjetorit 2008 në të cilën duhet të jetë e bazuar procedura e miratuar e bërë ndërmjet ECLO dhe Doganës së Kosovës për qëllime të implementimit të IPA ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

Lirimi nga TVSH-ja në kufi është çështje fundamentale me të cilën duhet të merret Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) sikurse në çdo Shtet Anëtarë i BE-së dhe e rregulluar me legjislacionin të TVSH-së. Administrimi i mëtejme pas lirimit në kufi është në të vërtetë saktësisht çështje e Administratës Tatimore. Prandaj, ATK-ja duhet të informohet qysh prej fillimit kur e fillon procedurën për lirim të importeve të mallrave të kontraktorëve të KE-së lidhur me kontratat e KE-së: kjo në të vërtetë nuk është vetëm çështje se a do të paguhet TVSH-ja në kufi, mirëpo gjithashtu çështje e shfrytëzimit të vërtetë e të këtyre mallrave për qëllime të lirimit (në këtë rast të ashtuquajturat për qëllime të përjashtimit), mos ushtrimit të së drejtës së zbritjes së TVSH-së së zbritshme në deklaratën e TVSH për importet e liruara, rishikimit të mallrave të liruara, në veçanti mallrave kapitale që nuk janë apo nuk shfrytëzohen më për qëllime të cilat fillimisht janë planifikuar ose që eventualisht janë shitur.

Një kontraktor i KE-së i cili dëshiron që të importojë mallra për qëllime të një kontrate të KE-së duhet saktësisht të zbatojnë principet e procedurave sikurse janë shpjeguar në pjesën 1 më lartë.

2. Importet e mallrave të bëra nga kontraktorët e KE-së në Kosovë:

Procedura saktësisht zbaton të njëjtin koncept sikurse është përmendur në III, pjesa 1,2 më lartë dhe urdhër blerja lidhet vetëm me implementimin e nën-paragrafit 1.3 të nenit 11 të Ligjit të TVSH-së Nr. 03/L-114 të 18 Dhjetorit 2008 lidhur me mos ngarkimin e TVSH-së në importet e bëra nga kontraktorët e KE-së lidhur me projektet e bëra nga kontraktorët e KE-së lidhur me projektet e KE-së.

2.1. Urdhër blerja me kërkesën për lirim nga TVSH-ja në import:

2.1.1. Kontraktori i KE-së aplikon në ECLO për të marrë formën e “Urdhër Blerjes me kërkesë për lirim të TVSH-së” për import:

Kontraktori i KE-së aplikon në ECLO dhe merr nga ECLO formën e plotësuar të “Urdhër blerjes për lirim” për import – shih Aneksin e Modelit të modifikuar 3 të BE-së. Koncepti i Urdhër blerjes veç është zhvilluar për implementimin e “Procedurës për blerjet e përjashtuara të 20/11/2006”.

2.1.2. Urdhër blerja me kërkesën për lirim nga TVSh-ja krijohet në 4 kopje (origjinale):

Origjinali Nr. 1: Një për dosjen e kontratës së ECLO

Origjinali Nr. 2: Një për kontraktorin e KE-së

Origjinali Nr. 3: Një për ta prezantuar në zyrën kompetente të doganës

Origjinali Nr. 4: Një për Administratën Tatimore.

Kontraktori i KE-së i pranon origjinalet Nr. 2, 3 dhe 4 dhe duhet ti ofrojë Origjinalin Nr. 4 zyrës kompetent të Doganës dhe Origjinalin Nr. 4 Zyrës Qendrore të ATK-së.

2.2. Dokumenti Doganor (DUD) lidhur me një import të mallrave të bërë nga një Kontraktor i KE-së për qëllime të kontratës së KE-së.

Në dokumentin e DUD-it duhet të paraqitet teksti si në vijim: Nga dogana nuk është ngarkuar TVSH + <titulli i kontratës> + <numri i kontratës> + <të dhënat e referencës të urdhër blerjes me kërkesë për lirim nga TVSh-ja>.

2.3. TVSH-ja në nivelin e importit të mallrave të bërë nga Kontraktori i KE-së lidhur me Kontratat e KE-së.

Nuk ka hyrje të TVSH-së për tu thyer meqë nga Dogana nuk është ngarkuar TVSH nëse dokumenti I DUD-it krijohet në emër të Kontraktorit të KE-së.

2.4. TVSH-ja në nivelin e importit të mallrave të bërë nga furnizuesit dhe nën-kontraktorët e Kontraktorit të KE-së lidhur me ekzekutimin e Kontratës së KE-së.

Furnizuesit dhe nën-kontraktorët e kontraktorëve të KE-së nuk janë të liruar nga TVSH-ja kur të bëjnë importimin e mallrave për nevojat e kontratave të KE-së. Kjo gjithashtu do të thotë se TVSH-ja e importit e paguar në kufi është e zbritshme në deklaratën e TVSH-së. Mirëpo furnizimet e mallrave të bëra për kontraktorët e KE janë me zero shkallë. Furnizuesit dhe nën-kontraktorët e kontraktorëve të KE pra mundë të ushtrojnë të drejtën e zbritjes së TVSH-së së tyre në deklaratat e TVSH-së dhe rimbursimet e deklaratave të TVSH-së bien nën rregullat normale të TVSH-së.

IV. Tatimet tjera përveç TVSH-së

1. Të ardhurat:

Të ardhurat që dalin nga Kontratat e KE-së për kontraktorët e KE që operojnë në Kosovë duhet të jenë të tatueshme në Kosovë në pajtueshmëri me legjislacionin e tatimit direkt të Kosovës (Tatimi në të Ardhurat Personale dhe Tatimi në të Ardhurat e Korporatave). Mirëpo, personat fizik dhe juridik, duke përfshirë stafin e huaj, nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian ose shtetet tjera të pranueshme sipas IPA (duke përfshirë Kosovën), që ekzekutojnë kontratat e financuara nga Komuniteti do të jenë të liruar nga këto tatime direkte në Kosovë.

2. Tatimet në burim në paga duke u mbështetur në nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-115 Mbi Tatimin në të Ardhurat Personale:

- 2.1. Çdo person fizik dhe juridik–Kontraktori i KE-së – pra gjithashtu duke përfshirë këta Kontraktorë të KE nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian ose shtetet tjera të pranueshme sipas IPA si dhe duke përfshirë edhe vetë Kosovën – duke punësuar stafin vendor, duhet si punëdhënës të ndalin tatimin në burim nga të ardhurat bruto nga pagat e të punësuarve të tyre vendor gjatë çdo periudhe të pagesës së pagave dhe duhet të dorëzojnë një pasqyrë të tatimit në burim brenda 15 ditësh pas ditës së fundit të çdo muaji kalendarik.
- 2.2. Këta Kontraktorë të KE-së – punëdhënës sikurse është referuar në 2.1 më lartë gjithashtu duhet të dorëzojnë një pasqyrë vjetore të barazimit të tatimit deri me 31 Janar të vitit që pason pas periudhës tatimore.
- 2.3. Ky kontraktor i KE-së – punëdhënës sikurse është referuar në 2.1 më lartë duhet të sigurojë një certifikatë të tatimit të ndalur në burim deri me 1 Mars të vitit që pason pas periudhës tatimore, për çdo të punësuar nga rroga e të cilëve është ndalë tatimi në burim në paga.

3. Kontributet pensionale duke u mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-084 që e plotëson Rregulloren e UNMIK-ut 2005/20 që e plotëson Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 mbi Trustin e Kursimeve Pensionale.

- 3.1. Kontributet pensionale për të punësuarit mbahen në burim nga punëdhënësi në baza mujore në shkallën minimale prej 5% në pagat bruto të të punësuarit. Punëdhënësi kontribuon gjithashtu 5% për të punësuarit e cila llogaritet me 5% në pagat bruto të të punësuarve. Punëdhënësit dhe të punësuarit mundën vullnetarisht të kontribuojnë një shumë shtesë deri në 10% të pagës bruto. Pagesa bëhet me një deklaratë speciale në njërën nga bankat që veprojnë në Kosovë dhe të cilat janë të licencuara nga Banka Qendrore.
- 3.2. Pesë (5%) + eventualisht dhjetë (10%) në mënyrë vullnetare që punëdhënësi kontribuon për të punësuarin, mundë të zbritet nga punëdhënësi si shpenzim direkt për qëllime të tatimit në të ardhura. Ky shpenzim duhet të zbritet në shtetin e kontraktorit të KE-së sepse ky nuk dorëzon deklaratë vjetore mbi tatimin në të ardhura në Kosovë.
- 3.3. Pesë (5%) + eventualisht dhjetë (10%) në mënyrë vullnetare që kontribuon i punësuarin do të zbritet nga pagat e tij bruto. Bilanci i mbetur pas këtyre zbritjeve do të përbëjë bazën tatimore në të cilën do të implementohen normat tatimore të aplikueshme.
- 3.4. Punëdhënësit gjithashtu janë të detyruar të dorëzojnë një pasqyrë tremujore mbi kontributet të cilat i kanë ndalur në burim në pagën bruto të të punësuarve të tyre.

*Ju mundë të shkarkoni të gjitha format tatimore nga Web-faqja e Administratës
Tatimore www.atk-ks.org*

V. Obligimet tjera të kontabilitetit dhe të pagesave

1. Shënimet e kontabilitetit të kontraktorëve të KE-së dhe pagesat bankare për furnizuesit dhe nën-kontraktorët:

- 1.1. Kontraktori i KE-së do të mban kontabilitet dhe shënime të veçanta të ndara për kontratat me KE. *Ai duhet të krijojë një listë mujore të faturave që i janë lëshuar atij dhe dokumentat e vërtetuar doganor dhe të vërtetoj autenticitetin e tyre dhe të i dorëzoj këto lista në Zyrën regjionale Tatimore.*

Ai gjithashtu duhet të mbajë ditar në baza ditore për të përcjell shfrytëzimin e blerjeve të tij dhe mallrave të tij të importuara dhe përfundimin e kontratave afat gjate sikurse ato të vendpunishteve të ndërtesave ose projekteve të ndërtimit dhe instalimit nëse ka. Termi “vendpunishtja e ndërtimit ose projekti i ndërtimit ose instalimit” përfshinë jo vetëm ndërtimin e ndërtesave mirëpo gjithashtu edhe ndërtimin e rrugëve, urave ose kanaleve, shtrirjen e gypave dhe gërmimin dhe gropimin. Këto kontrata duhet të konsiderohen të përfunduara së paku në intervalet në fund të çdo viti kalendarik.

- 1.2. Kontraktori i KE-së do të bëjë të gjitha pagesat për furnizuesit dhe nën-kontraktorët nëpërmes të bankës dhe do të mbajë kopjet e këtyre pagesave bankare.

CERTIFIKATË MBI STATUSIN E KONTRAKTORIT TË KE
(Aneksi 1)

E lëshuar nga Autoriteti kompetent i ECLO ose përfaqësuesi i tij për nevojat e Administratës Tatimore të Republikës së Kosovës (neni 26 i marrëveshjes IPA)

I nënshkruari (Emri, adresa e autoritetit të ECLO-s + emri dhe pozita e personit i cili e vërteton)

.....
.....
.....
.....
.....
.....

Vërteton se

(Emri i plotë ose Emri i korporatës dhe adresa e Kontraktorit të KE në Kosovë dhe në vendin e tij të origjinës nëse është e aplikueshme + emri dhe adresa e përfaqësuesit përgjegjës në Kosovë):

.....
.....
.....
.....
.....
.....

është kontraktor i KE – neni 26 i Marrëveshjes IPA të kontratës së KE (titulli i kontratës – Data – numri i kontratës – Vendi dhe adresa e ekzekutimit të projektit)

.....
.....
.....

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të ekzekutuara

.....
.....
.....


Data.....Nënshkrimi.....

Data e vulës së zyrës

(Emri/ grada e zyrtarit të nënshkruar të Autoritetit të ECLO)

Aneksi 2(1): KE – Financimi lidhur me furnizimet e mallrave dhe shërbimeve brenda territorit të Kosovës

Implementimi i procedurës për blerjet e përjashtuara të 20/11/2006: Furnizimet në relacionin Përfitues – kontraktorët IPA sipas marrëveshjes IPA – neni 26, mundë të konsiderohen si përjashtime sipas legjislacionit ekzistues të TVSH-së




Procedura për blerjet e përjashtuara 20/11/2006

⁴ Procedura për blerjet e përjashtuara e 20/11/2006 në Kosovë, lejon zbritjen e TVSH-së së zbritshme. Është në linjë me Direktivën e BE-së mbi TVSH që furnizimet e "produktit të kryer" të konsiderohen si furnizime të trajtuara si eksporte – mirëpo Direktiva e BE-së e TVSH-së lejon që këto furnizime të trajtohen si eksporte vetëm nëse bëhen për organizatat ndërkombëtare ose të bëra nën aranzhimin diplomatik dhe konsullor. Kjo procedurë është propozuar si masë transitorë në Ligjin e Ri të TVSH-së i cili planifikohet të hyj në fuqi me 1 janar 2010.

Në këtë kontekst pozita që kontraktori IPA kontraktin me KE është e justifikueshme – kjo e sjell procedurën për blerjet e përjashtuara në linjë me Direktivën e TVSH-së së BE-së.

Aneksi 2 (2): KE – Financimi lidhur me importet e mallrave



ANEKSI 3:
Logo e Bashkimit Evropian

URDHËR BLERJE ME KËRKESË PËR LIRIM NGA TVSH

Për:

.....
.....

Nga:

.....
.....

Ref:Emri kontaktues.....Data:.....
Nr. i kontratës.: CRIS Nr i kontratës

Subjekti: Urdhër blerje me kërkesë për lirim nga TVSH-ja

I nderuar Zotëri/Zonjë,

Zyra Ndërlidhëse e Komitetit Evropian për Kosovën është e liruar nga TVSH-ja në importe dhe në blerje të mallrave dhe shërbimeve duke u mbështetur në nën-paragrafin 1.5 të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-114 të 18 Dhjetorit 2008 Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Me partnerin tonë implementues

.....
.....
.....

Projekti në vijim që aktualisht zhvillohet

.....
.....

i dizajnuar për të mbështetur

.....
.....

Projekti financohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komitetit Evropian për Kosovën. Të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve ose importet e mallrave nga ajo, sikur që është paraparë në legjislacionin e mësipërm, janë të liruara nga TVSH-ja.

Për implementimin e këtij projekti, partneri i projektit tonë ka vendosur që të blejë mallrat /shërbimet si në vijim nga kompania e juaj/të cilat do të importohen në Kosovë. **Blerjet e këtyre artikujve do të financohen nga buxheti i ECLO dhe prandaj nuk do të ngarkohet TVSH.**

Lista e mallrave dhe shërbimeve:

<u>Nr</u>	<u>Sasia</u>	<u>Njësia Matëse</u>	<u>Nr Identifikues</u>	<u>Përshkrimi</u>
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				

Personi përgjegjës për ekzekutimin e blerjes në llogari të partnerit tonë implementues është Z./Znj

.....
adresa:.....
.....me nr e ID /pasaportës.....

Në pajtueshmëri me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga ECLO dhe Administrata Tatimore e Kosovës, ai/ajo është e autorizuar që të vërtetoj me nënshkrimin e atij/asaj se nuk do të ngarkohet dhe do të mbliidhet TVSH lidhur me faturën(t)

Nr(at).....
.....

Ju faleminderit për bashkëpunim

I juaji sinqerisht

Emri dhe nënshkrimi i Udhëheqësit të Ekipit të ECLO